

KONTRATE TRANSFERIMI TE PJESEVE TE KAPITALIT

Sot, me daten 03.02.2020, ne Tirane eshte nenshkruar kjo Kontrate transferimi e pjeseve te kapitalit te shoqerise "SUHA T" Shpk :

Transferuesi : Shoqeria "FAVINA" Sh.p.k, e cila figuron e regjistruar me Vendimin Nr.10126 date 03.04.1995 te Gjykates Tirane me NUIS J64104078V adrese Rr. Ismail Qemali, Lagjia 7, Korçe, Shqiperi, me NUIS J64104078V perfaqesuar nga Administratori Z. Viktor Qylafi, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar "Transferues";

Perfituesi: Shoqeria "Gener 2" Sh.p.k., person juridik shqiptar, regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare me Vendimin Nr. 10145, date 03.09.2003, i paisur me Nipt Nr. K 58615301 M, perfaqesuar nga Administratori, Zj. Artilla Ulaj, me adrese komunikimi: Rruga "Papa Gjon Pali I II-te", Tirane, Shqiperi., referuar me poshte si "Perfitues".

Te pergjithshme

- A. Palet jane ortake te shoqerise "SUHA T" regjistruar ne Regjistrin Tregtar ne Date 15.03.2018 me NUIS L 81521046 K, ne adresen : Rruga "Papa Gjon Pali II, Ndertesa Nr.12, Aba Business Center, Kati I 7,Tirane, Shqiperi.
- B. **Shoqeria "FAVINA" Sh.p.k** zoteron ne kapitalin e Shoqerise "SUHA T" , 30.000 Leke, i ndare ne 30 pjese me vlere nominale 1000 Leke secila.
- C. **Shoqeria "Gener 2" Sh.p.k** zoteron ne kapitalin e Shoqerise "SUHA T" 70.000 Leke i ndare ne 70 pjese me vlere nominale 1000 Leke secila.

Mbeshtetur ne Ligjin nr. 7850, date 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise" dhe ne Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", te ndryshuar neni 101 "Largimi i Ortakut per shkaqe te arsyeshme", dhe ne Vendimin Nr. 22 Janar 2020, te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise, Palet bien dakort si me poshte :

Neni 1

Objekti

1.1. Objekti i kesaj kontrate eshte transferimi i kuotes se Shoqerise "Favina" sh.p.k. ne shoqerine "SUHA T", qe perbehet nga 30 (tridhjete) pjese te kapitalit te Shoqerise "SUHA T", me nje vlere nominale prej 30.000 (Tridhjete mije) Leke, te cilat perfaqesojne 30 % te Kapitalit te Shoqerise "SUHA T". Keto pjese transferohen nga Transferuesi ne pronesi te Perfituesit.

1.2. Perfituesi pranon pronesine mbi 30 (tridhjete) pjese te kapitalit te Shoqerise, me nje vlere nominale prej 30.000 (Tridhjete mije) Leke secila, te cilat perfaqesojne 30 % te Kapitalit te Shoqerise "SUHA T" dhe pranon te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kjo pronesi.

Neni 2

Transaksioni

2.1. Transferimi i kapitalit do te jete pa kundershperblim.

Neni 3

Regjistrimi

3.1. Transferuesi dhe Perfituesi pranojne te zbatojne e te japin, me kerkese te pales tjetere dhe/ose Shoqerise, te gjitha dokumentacionin e duhur ne pergjithesi, per te kryer çdo gje te nevojshme per transferimin e pjeseve te kapitalit, qe jane objekt i kesaj kontrate, dhe per te regjistruar kete transferim ne Regjistrin Tregtar prane QKB si edhe ne çdo organ tjetere shqiptar sipas ligjeve shqiptare.

Neni 4

Te ndryshme

- 4.1. Palet garantojne se ata e kane lexuar dhe kane kuptuar kontraten dhe nenet e saj.
- 4.2. Kjo kontrate mes paleve eshte nje e tere persa i perket objektit dhe zevendeson te tera diskutimet dhe marreveshjet e meparshme.
- 4.3. Palet nuk mund t'i kalojne te tereve, te drejta apo detyrime qe rrjedhin nga kjo kontrate, pa pelqimin paraprak me shkrim te Pales tjetere.
- 4.4. Kjo kontrate, si dhe çdo marreveshje apo dokument tjetere qe ka lidhje me te, do te ekzekutohen dhe interpretohen sipas Ligjit Shqiptar. Juridiksioni kompetent eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.
- 4.5. Kjo marreveshje eshte pergatitur ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte ligjore.

Kontrata eshte bazuar ne artikullin 705 te Kodit Civil dhe ne Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Kontrata u lexua para paleve, u gjend e rregullt, ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, dhe u nenshkrua ne menyre te rregullt, nga palet, perpara meje, dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

TRANSFERUESI

FAVINA SHPK



PERFITUESI

GENER 2 SHPK

